REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-IV-20-0059 15 tetor 2020

Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP.

Parashtruesi i kërkesës

Për: AKP

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Sylejman Shumolli gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Teuta Ibrahimi, gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 15 tetor 2020, lëshon këtë:

U DHËZIM

1. AKP udhëzohet që së pari të bëj një spot informues, me qëllim të informimit të palëve të interesit se të gjitha informatat në lidhje me publikimin e njoftimeve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, nuk do të publikohen më në gazetat e shkruara, por tani e tutje publikimi i njoftimeve do të bëhet vetëm në mediat televizive dhe ato elektronike. Spoti informues duhet të transmetohet në televizionin publik RTK 1 në gjuhën shqipe dhe RTK 2 në gjuhën serbe si dhe në portalet online, për 5 ditë njëpasnjëshme në kohëzgjatje minimale prej 30 sekonda me video dhe zë, duke fiiluar ndërmjet orës 17:00 – 21:00.

2. AKP udhëzohet që për çdo Njoftim të Fillimit të Procedurës së Likuidimit të NSH-ve dhe Publikimit të Listës së Punëtorëve me të Drejta Legjitime në 20 % të të Ardhurave nga Privatizimi ose Likuidimi i NSH, të publikoj njoftimet në lidhje me to në RTK 1 dhe RTK 2, për 5 ditë të njëpasnjëshme, në kohëzgjatje prej minimum 30 sekonda me video dhe zë, duke filluar ndërmjet orës 17:00 deri në 21:00.

3. Të gjitha shpalljet duhet të lidhen me faqen e internetit të AKP-së.

4. Ky udhëzim mbetet në fuqi deri në rifillimin e shtypjes së gazetave ditore në Republikën e Kosovës.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 21 shtator 2020, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) parashtroi kërkesë për udhëzim ligjor, me të cilën kërkoi që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (Dhoma e Posaçme) të ofrojë udhëzim sa i përket çështjes se "*deri në përfundimin e situatës së pandemisë globale të shpallur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (më tej OBSH) për virusin Covid-19, a mund të vazhdoj AKP të shpallë njoftimet sa i përket fillimit të likuidimit dhe listave të 20 % të shitjes së aseteve vetëm në portalet online në Republikën e Kosovës, për një afat të arsyeshëm kohor, shpallje këto të cilat do të ndërlidheshin automatikisht me faqen e internetit të AKP*".

Me 01 tetor 2020, Dhoma e Posaçme lëshoi urdhër për parashtruesin e kërkesës, duke kërkuar nga e njëjta që të precizoj kërkesën për udhëzim ligjor në drejtim të: mënyrave të komunikimit që i ka zbatuar AKP lidhur me fillimin e likuidimit të NSH, deri më tani, me kreditorët potencial, sa është e mundur që komunikimi për listat përfundimtare për 20 %, të komunikohet drejt për së drejti me ish punëtorët e NSH, apo përmes sindikatës së NSH dhe në gjendjen e tanishme, cilat janë propozimet konkrete për të komunikuar me kreditorët potencial lidhur me fillimin e procedurave të likuidimit të NSH dhe punëtorët të cilët nuk janë përfshirë në listën preliminare apo përfundimtare për 20 %. Lidhur me këtë çështje gjykata caktoi seancë dëgjimore.

Me 05 tetor 2020, Dhoma e Posaçme mbajti seancë dëgjimore. Në fjalën e tyre përfaqësuesit e AKP-së kanë elaboruar kërkesën për udhëzim ligjor. Ndër të tjerash pohuan se, në shtojcën e ligjit të AKP janë të caktuara afatet kohore për publikimin e procesit të likuidimit, pas 15 ditëve të bëhet shpallja e dytë dhe se në Kosovë gazetat e shtypura nuk shtypën më, kjo e ka bërë të pa mundur procesin e shpalljes së likuidimit në rastin konkret për NSH Vello Trogovina. Më tej, pohuan se sa i përket shpalljes së listave të punëtorëve në kërkesën për udhëzim janë referuar në rregulloren e UNMIK-ut 2003/13, neni 10.3 që lista zyrtare e të punësuarve me të drejta legjitime të lëshuar nga AKP së bashku me të drejtën e ankesës në pajtim me nenin 10.6 të Rregullores, publikohen në dy ditë të një pas njëshme dhe në fundjavë në gazetat kryesore të gjuhës shqipe dhe në gazetat kryesore në gjuhën serbe. Në fund, përfaqësuesit e AKP-së janë udhëzuar nga gjyqtari kryesues, se mund të dorëzojnë një precizim më shkrim sa i përket mënyrës së publikimit dhe çështjeve të tjera që lidhen me publikimin e njoftimeve.

Me 07 tetor 2020 AKP dorëzoi një parashtresë me të cilën precizoi kërkesën për udhëzim ligjor, në drejtim të mënyrave të komunikimit me kreditorët potencial dhe përfituesit potencial të listës së 20 %, si dhe orarit se kur duhet të bëhen publikimet online dhe kohëzgjatjes së këtyre publikimeve.

<u>Arsyetimi Ligjor</u>

Kërkesa për udhëzim ligjor është e pranueshme.

Neni 48.1 i shtojës së Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04/l-034 (shtojca e Ligjit për AKP) parasheh:

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO
PRISHTINË

Në çdo kohë gjatë procedurës së Likuidimit, Autoriteti i Likuidimit mund të parashtrojë kërkesë me shkrim për të kërkuar nga Gjykata udhëzime në lidhje me dispozita të ligjit, përfshirë çështjet e pajtueshmërisë me këtë Ligj. Autoriteti i Likuidimit në të njëjtën kohë i siguron një kopje të kërkesës së tillë Komitetit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palëve të tjera të interesit sipas udhëzimit të Gjykatës. Gjykata lëshon vendim lidhur me këtë kërkesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas dorëzimit.

Neni 7.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP parasheh:

Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së Vendimit për likuidim, Agjencia publikon, apo kërkon nga Autoriteti i Likuidimit të publikojë njoftimin me informatat e cekura në paragrafin 2 të këtij neni (Njoftimi për likuidim). Publikimi i Njoftimit për likuidim bëhet në pajtim me Dispozitat për Shpallje të kësaj Shtojce.

Neni 49 i shtojcës së Ligjit për AKP parasheh:

Të gjitha njoftimet formale sipas këtij Ligji publikohen, së paku, si në vijim; 1.1.në serbisht dhe shqip në gazetat me tirazh më të madh në Kosovë; dhe 1.2.në serbisht në një apo më shumë gazeta të gjuhës serbe me tirazh të madh në Serbi dhe Mal të Zi, nëse Autoriteti i Likuidimit konsideron se është e nevojshme. 1.3.në një publikim në gjuhën angleze që ka tirazh të madh në Evropë.

Neni 10.3 i rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 parasheh:

Lista Zyrtare e të punësuarve me të drejta legjitime të lëshuar nga Agjencia, së bashku me njoftimin për të drejtën e ankesës, në pajtim me paragrafin 10.6 publikohen në dy ditë pune të njëpasnjëshme dhe në fundjavën vijuese në gazetat kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjerë në Kosovë dhe në gazetat kryesore në gjuhën serbe.

Dhoma e Posaçme vlerëson se në rrethana normale, dispozitat e lartcekura e rregullojnë mjaftueshëm çështjen e shpalljes së njoftimeve për fillimin e procesit të likuidimit për Ndërmarrjet Shoqërore (NSH), nën autoritetin administrativ të AKP dhe shpalljen e listave të punëtorëve të NSH për 20 % të shitjes së aseteve të tyre. Nën rrethanat e ditura botërisht dhe nga gjendja e pandemisë globale të shpallur nga OBSH-ja prej datës 11 mars 2020, lidhur me situatën e krijuar me virusin Covid-19 "Coronavirus", është e nevojshme të gjendet një zgjidhje alternative për zbatim të këtyre dispozitave ligjore, me qëllim që AKP si organ i pavarur publik të ndërmerr hapa të mëtutjeshëm rreth përmbushjes se mandatit të saj, ne përputhje me ligjin nr. 04/L-034, sa i përket njoftimit lidhur me fillimin e likuidimit si dhe publikimin e listave të punëtorëve për përfitimin nga 20 % i privatizimit dhe likuidimit të NSH-ve.

Dhoma e Posaçme konsideron se duhet të bëhet një zgjidhje alternative për zbatim të dispozitave ligjore të lartcekura, me qëllim që palët e interesit (kreditorët potencialë ndaj NSH-ve dhe punëtorët që preken nga lista e 20 %), të njoftohen me kohë dhe në mënyrë

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO
PRISHTINË A

të duhur për mënyrën e shpalljeve që do ta zbatoj tani e tutje AKP. Palët duhet të informohen mirë dhe në mënyrë të duhur për të drejtat që ju takojnë dhe për rrugët që duhet ti ndjekin për realizimin e të drejtave të tyre të pretenduara. Njoftimi me kohë dhe në mënyrë të duhur i palëve është një detyrim ligjor i Agjencisë. Pra, palët duhet të informohen drejt mbi ecurinë e një procedurë që pritet të zhvillohet ose që është zhvilluar nga Agjencia si dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme juridike për kundërshtimin e atyre veprimeve ose vendimeve. Agjencia, gjatë gjithë zhvillimit të një procedure duhet të siguroj që mos informimi / mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Në veçanti, Agjencia duhet të informoj palët për të drejtat dhe detyrimet e tyre në procedurë, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të tyre gjatë procedurës. Si rregull, organi që zhvillon një procedurë duhet ti siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth mënyrës si të fillojnë një procedurë të caktuar për të kërkuar ndonjë të drejtë apo për të zhvilluar procedurën ndaj një akti të nxjerrë nga organi dhe mjetet juridike në dispozicion të palës dhe mënyrën e ushtrimit të tyre.

Në rastin konkret duket objektivisht e pamundur komunikimi individual me të gjitha palët e përfshira nga vet Agjencia si për shkak të mungesës së resurseve, ashtu edhe për faktin e mungesës së të dhënave në lidhje me adresat apo mundësitë e kontaktit me palët e përfshira. Për më tepër një standard i tillë nuk është aplikuar nga Agjencia as në rrethana normale dhe nuk duket të ketë detyrime të tilla ligjore për AKP-në, veçanërisht në rrethanat aktuale.

Andaj, Dhoma e Posaçme vlerëson se AKP siç është udhëzuar në pikën 1 të këtij udhëzimi, duhet që së pari të bëjë një spot informues, i cili duhet të transmetohet në televizionin publik RTK 1 në gjuhën shqipe dhe RTK 2 në gjuhën serbe, për 5 ditë njëpasnjëshme në kohëzgjatje minimum 30 sekonda me video dhe zë, duke filluar ndërmjet orës 17:00 – 21:00, me të cilin do të informohen palët e interesit se për shkak të pandemisë nuk janë duke u shtypur gazetat ditore dhe se tash e tutje të gjitha njoftimet lidhur me likuidimin e NSH dhe publikimin e listave për 20 % do të bëhen në televizionin publik RTK 1 në gjuhën shqipe, RTK 2 në gjuhën serbe dhe në portalet online.

Dhoma e Posaçme e ka udhëzuar AKP si në pikën 2 të këtij udhëzimi, ashtu që e njëjta duhet që për çdo procedurë sa i përket fillimit të likuidimit të NSH dhe publikimit të listës së 20 % të punëtorëve të NSH, të bëjë publikimin e njoftimeve në RTK1 dhe RTK 2, për 5 ditë të njëpasnjëshme, në kohëzgjatje prej minimum 30 sekonda me video dhe zë, duke filluar ndërmjet orës 17:00 deri në 21:00. Njoftimi duhet të jetë lehtë i kuptueshëm për palët e interesit dhe duhet të përmbaj informata që palët e interesuara t'i qasen lehtë faqes zyrtare të internetit të AKP. Po ashtu, AKP është udhëzuar që njoftimet ti publikoj në 3 portale në Republikën e Kosovës në gjuhën shqipe dhe serbe, për 5 ditë të njëpasnjëshme dhe t'i referohet faqes së internetit të AKP.

Andaj, Dhoma e Posaçme, vie në përfundim se me qëllim që AKP si organ i pavarur publik të mund të përmbush mandatin e saj sipas ligjit nr. 04/L-034 dhe Shtojcës së tij,

në rrethanat e krijuara si pasojë e Covid-19, për aq kohë sa zgjat kjo gjendje dhe në varësi të kufizimeve apo lehtësimeve të masave të parapara për mbrojtje nga Covid-19, të përcaktuara nga qeveria dhe institucionet shëndetësore, pa paragjykuar efektet, si dhe me qëllim që palët e interesit të njoftohen në mënyrë të rregullt dhe të drejtë, ofron këtë zgjidhje specifike si në dispozitiv të këtij udhëzimi.

Për këtë, në pajtim me nenin 48.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP dhe kërkesës së saj, jepet ky udhëzim.

Shpenzimet Gjyqësore

Parashtruesi i kërkesës tani më ka paguar taksën gjyqësore për kërkesën për udhëzim ligjor në shumë prej 100.00 € dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar kryesues

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar

Teuta Ibrahimi, Gjyqtare

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO
SAKTËSINË E KOPJES E VERTETON REGJISTRUESI
TAČNOST KOPIJE POTVRĐUJE REGISTRATOR
ACCURACY OF COPY CERTIFIED BY REGISTRAR

Urdhër për zyrën e regjistrimit

Udhëzimi duhet t'i dorëzohet:
-AKP-së,
-Të gjithë gjyqtarëve të Dhomës së Posaçme, si dhe
-Të publikohet në web-faqe të gjykatës.